

P.nr.658/15

Gjykata Themelore në Prizren - departamenti i përgjithshëm, gjyqtari Artan Sejranit, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Florije Kolukaj procesbajtëse, në lëndën penale kundër të akuzuarit M. T. nga fshati G. Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 243 parag. 2 të KPK-së dhe veprën penale shmangia nga tatimi nga neni 249 parag. 1 të KPK-së, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr.2415/12 të datës 01.04.2015 pas mbajtjes së shqyrtimit të dytë - publik në praninë e Prokurorit të Shtetit në Prizren - departamenti i përgjithshëm Mehreme Hoxha dhe të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij av.M. S. nga Prishtina, me datë 24.11.2016 publikisht mori dhe shpalli këtë:

AKTGJYKIM

I akuzuari:

M. T. TC., nga i ati A. dhe e ëma M., e lindur D. i lindur me dt. në Prizren, tani me vendbanim në fshatin - Komuna e Prizrenit, i martuar, babë i 4 fëmive, punëtor, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal

ËSHTË FAJTOR

I. Se ne periudhën kohore 12.04 - 15.06.2011 në Prizren, në kohë të pacaktuar me qëllim për ti sjell vetës apo tjetrit përfitim material të kundërligjshëm organizon, merr pjesë apo ndihmon në organizimin e bixhozit, lojërave të llojeve të kazinove, ose lojërave të fatit për të cilave nuk iu është dhënë licenca, leja apo konvencioni i organit kompetent, në atë mënyrë që me rastin e kontrollit dhe zyrtarët e ATK -së, policisë së Kosovës dhe doganës në lokalet e kompanisë "A S" në Prizren, në rrugën "J. G." dhe në rr. "Q Q", janë gjetur dy automate dhe një shtëpizë kompjuteri "G me", të pa licencuara.

Këso dore kryen veprën penale organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 243 parag. 2 të KPK-së.

II. Se me datë, dhe vend të njëjtë si në dispozitivin nën I të kësaj aktakuze në kompanisë "A S", në Prizren me qëllim që ti shmangët pjesërisht apo tërësisht pagimit të tatimit, tarifave apo kontributeve tjera të përcaktuara me ligj, jep të dhëna të pa vërteta apo nuk përfshin informata për të ardhurat të tij, apo faktet tjera relevante për vlerësimin të detyrimeve të këtilla, në atë mënyrë që me rastin e kontrollit nga zyrtarët e ATK-së, nuk ofron të dhëna të mjaftueshme në lidhje me punën dhe fitimin, me ç'rast me këto veprime shmangët nga tatimi duke i shkaktuar humbje buxhetit të Kosovës në vlerë prej 1.894, 80 euro, shumë kjo e dhënë nga eksperti ekonomik financiar ecc.A K me datë 20.01.2015.

Këso dore kryen veprën penale shmangie nga tatimi nga neni 249 parag. 1 të KPK-së.



Andaj gjykata në kuptim të nenit 7, 8, 9, 10, 21, 41, 45, 46, 47, 50, 80, nenit 243 paragraf 2 dhe 249 paragraf 1 të KP-së, dhe nenit 365 të KPP-së, të akuzuarin e:

GJYKON

- për veprën penale si nën I të dispozitivit ia shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve.
- për veprën penale si nën II të dispozitivit ia shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) muajve dhe dënimin me gjobë në shumë prej 300 (treqind) euro.

Duke aplikuar dispozitat e neni 80 të KPK-së, të akuzuarit i shqiptohet dënimi unik me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajve dhe dënimin me gjobë në shumë prej 300 (treqind) euro.

Në bazë të nenit 47 të KP, me pëlqimin e të akuzuarit, dënimi i shqiptuar me burg në kohëzgjatje prej 4 (katër) katër muajve, zëvendësohet me dënim me gjobë në shumën prej 1.200 (njëmijedyqind) euro.

- Duke aplikuar dispozitat e nenit 80 paragraf 2.4 të KP-së, të akuzuarit i shqiptohet për veprën penale nën I dhe II të dispozitivit, dënimin unik me gjobë në shumë prej 1.500 (njëmijepesëqind) euro, të cilën gjobë i akuzuari është i obliguar ta paguajë në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i akuzuari nuk dëshiron apo nuk mund të paguajë dënimin me gjobë, i njëjti zëvendësohet me dënim me burg, ashtu që për çdo 20 € të dënimit me gjobë do të caktohet një ditë burg.

Pala e dëmtuar ATK - Prizren, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontestin e rregullt juridiko civil.

Obligohet i akuzuari që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 100 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP.nr.2415/12 të datës 01.04.2015 kundër të akuzuarit M. T. nga fshati G. Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 243 paragraf 2 të KPK-së dhe veprën penale shmangia nga tatimi nga neni 249 paragraf 1 të KPK-së.

Gjykata në shqyrtimin e dytë pas pranimit të fajësisë nga i akuzuari, ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

I. Se në periudhën kohore 12.04 – 15.06.2011 në Prizren, në kohë të pacaktuar me qëllim për të sjell vetës apo tjetrit përfitim material të kundërligjshëm organizon, merr pjesë apo ndihmon në organizimin e bixhozit, lojërave të llojeve të lojërave të fatit për të cilave nuk iu është dhënë licenca, leja apo konvencionin i organit kompetent, në

atë mënyrë që me rastin e kontrollit dhe zyrtarët e ATK -së, policisë së Kosovës dhe doganës në lokalet e kompanisë "Arma SpA" në Prizren, në rrugën "J. ... " dhe në rr. " ... ", janë gjetur dy automate dhe një shtëpizë kompjuteri " Gara me qenë", të pa licencuara.

II. Se me datë, dhe vend të njëjtë si në dispozitivin nën I-të kësaj aktakuze në kompanisë "Arma SpA", në Prizren me qëllim që ti shmangët pjesërisht apo tërësisht pagimit të tatimit, tarifave apo kontributeve tjera të përcaktuara me ligj, jep të dhëna të pavërteta apo nuk përfshin informata për të ardhurat të tij, apo faktet tjera relevante për vlerësimin të detyrimeve të këtilla, në atë mënyrë që me rastin e kontrollit nga zyrtarët e ATK-së, nuk ofron të dhëna të mjaftueshme në lidhje me punën dhe fitimin, me ç'rast me këto veprime shmangët nga tatimi duke i shkaktuar humbje buxhetit të Kosovës në vlerë prej 1.894, 80 euro, shumë kjo e dhënë nga eksperti ekonomik financiar ecc. Ag. ... i, me datë 20.01.2015.

Gjykata gjendjen e këtyllë faktike e ka vërtetuar nga pranimit i fajsisë nga ana e të akuzuarit i cili në shqyrtimin e dytë vullnetarisht ka pranuar fajin, për shkak së cilës gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare gjykata, konform nenit 257 të KPP, nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit për veprat penale të cilat i vihen në barrë e që pranimit i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështetet në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhë në përfundim, se pranimit i fajsisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP dhe faktet që përmban aktakuza, në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 243 paragraf 2 të KPK-së dhe veprën penale shmangia nga tatimi nga neni 249 paragraf 1 të KPK-së, dhe për këto gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënim si në dispozitivin të këtij aktgjykimi, paraprakisht duke e vërtetuar përgjegjësinë e tij penalo juridike.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimin, duke mos gjetur rrethanë rënduese e që si rrethanë lehtësuese është marrë pranimit i fajsisë nga ana e të akuzuarit, sjellja korrekte pas kryerjes së veprës penale, pendimi i thellë, është njeri familjar, është mbajtës i familjes, andaj gjykata i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke menduar se dënimin i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimin që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla si dhe ky dënim do të ndikoj pozitivisht edhe në ambientin ku jeton ai apo edhe më gjerë.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarëve në kontest të rregullt civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë konform nenit 463 paragraf 1 e 2 të KPP.

Vendimi mbi shpenzimet dhe paushallin gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 453 paragraf 1 të KPP.



Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.


GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.658/15 të datës 24.11.2015.

Procesmbajtësja
Floriqe Kolukaj

Gjyqtari

Artan Sejrani

UDHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakenaqr ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.



Artan Sejrani